 <p>Tel: +355 4 22 69097 +355 4 22 69325 Fax: E-Mail: info@dpa.gov.al</p>	Politika për fushën e Akreditimit.	Kodi: DA-PO-015
		Rishikimi nr 2 Dt: 26.04.2021
		Faqe 1 nga 6

POLITIKA PËR FUSHËN E AKREDITIMIT.

1. Qëllimi

Në këtë dokument detajohet politika e DPA në lidhje me mënyrën e formulimit të fushës të akreditimit për skemat e akreditimit që DPA ofron. Kjo politikë aplikohet gjithashtu ëedhe me synimin për të përcaktuar burimet dhe ekspertizën teknike që do të aplikohet për vlerësimin e një OVK.

2. Fusha e veprimit.

Kjo politikë është e zbatuar tek të gjitha llojet e vlerësimeve të OVK për të saktësuar fushën e akreditimit.

3. Referencat

Politika e DPA bazohet në:

“ILAC- G18:04/2010 “Ushëzues për formulimin e fushave të akreditimit për laboratorët” EA 4/17 M:2008- Qëndrimi i EA për shprehjen përshkruese të fushave të akreditimit të laboratorëve mjekësorë”.

NACE Rev. 2- Në nomenklaturën statistikore të aktiviteteve ekonomike në Komunitetin Evropian.

S SH ISO/IEC 17025:2017, Vlerësimi i konformitetit - Kërkesat për organizmat akreditues që akreditojnë organet e vlerësimit të konformitetit

S SH ISO/IEC 15189:2012, “Laboratorët mjekësorë. Kërkesa të vecanta për cilësinë dhe kompetencën”

ISO/IEC 17020:2012 “Vlerësimi i konformitetit-Kërkesa për funksionimin e tipeve të ndryshme të trupave që kryejnë inspektim”

ISO/IEC 17024:2012 “Vlerësimi i konformitetit- Kërkesa për trupat që certifikojnë persona.

S SH ISO/IEC 17021-1:2015 “Vlerësimi I konformitetit kërkesa për trupat certifikues të sistemeve të menaxhimit”

ILAC G 28:07/2018 Udhëzues për formulimin e fushës së akreditimit për organet inspektuese.

ILAC-G29:06/2020 Udhëzues për harmonizimin e fushave të akreditimit sipas ISO/IEC 17025 për laboratorët WADA anti-doping

IAF ID 1:2014 Dokument informative I IAF për fushat e akreditimit të QMS dhe EMS.

IAF MD 8:2020 Zbatimi i ISO/IEC 17011:2017 inë fushën e sistemeve të menaxhimit të cilësisë së pajisjeve mjekësore (ISO 13485)

ISO/TS 22003:2013 Sistemet e menaxhimit të sigurisë ushqimore- Kërkesat për trupat që kryejnë auditim dhe certifikim të sistemeve të menaxhimit të sigurisë ushqimore.

ISO 50003: 2014 Sistemet e menaxhimit të energjisë — kërkesat për rupa që auditojnë dhe certifikojnë sistemet e menaxhimit të energjisë.

 <p>Tel: +355 4 22 69097 +355 4 22 69325 Fax: E-Mail: info@dpa.gov.al</p>	Politika për fushën e Akreditimit.	Kodi: DA-PO-015
		Rishikimi nr 2 Dt: 26.04.2021
		Faqe 2 nga 6

DA-IN-006- Udhëzues në lidhje me akreditimin sipas skemës së çertifikimit ISO 22301: 2012 – Sistemet e Menaxhimit të Vazhdimësisë së Biznesit (BCMS)

4. Formulimi i fushave të Akreditimit për Laboratorët e Testimit dhe Kalibrimit.

Përgjithësisht, formulimi i fushave të Akreditimit për Laboratorët e Testimit dhe Kalibrimit bëhet duke u bazuar në ILAC-G 18. Formulimi i fushes për laboratorët mjekësorë duhet të bëhet në përputhje me EA 4/17. Formulimi i fushës për laboratorët anti-doping do të kryejt në përputhje me ILAC G 29.

DPA vlerëson vetëm metodat testuese të mirënjohura (përfshi edhe kalibrimin). Fushat janë formuluar mbi bazën e formularit të aplikimit të dërguar nga aplikanti. Fusha për laboratorin është dhënë në DA-FO-022 i cituar tani e më tutje.

DPA akrediton laboratorët testues mbi bazën e metodave standarde kombëtare, rajonale dhe ndërkombëtare.

Kur është e nevojshme. DPA bën akreditim edhe mbi bazën e standardeve të tjerë kombëtarë të mirënjohur në fushën e sektorëve industrialë si, ASTM, ASHRAE, ARI, (SMEDP) –Metoda Standarte për Kontrollin e Bulmetrave, AOAC, etj.

Kur standardet kërkojnë sqarime ose hollësi të mëtejshme, janë fushat e aplikimit ato që japin identifikimin e metodës “ të brendëshme”.

Ndaj metodave të botuara në manuale të ndryshëm, DPA do të kërkonte të njëjtat identifikime.

Pa patur informacione të tjera nga ana e laboratorit, DPA do të konsideronte që aplikimi është kërkuar për versionin e fundit të metodës të testimit dhe fusha e vlerësimit do të jetë përgatitur sipas procedurës DA-PT-015 të DPA.

Tregohet sistematikisht data e botimit të çdo metode standarde ose të “brendëshme”.

Kur laboratori dëshëron që të akreditohet sipas një metode standarde të mëparëshme atëhere kjo metodë do të konsiderohej si “ metodë e brendëshme”

Metodat e brendëshme: Kur laboratori bën aplikimin për metodën e testimit të bazuar mbi një metodë testimi standarte, kjo shënohet në fushën e aplikimit për akreditim, me referimin ndaj Standartit dhe numurin shoqërues të “ metodës të brendëshme”. (Për shëmbull , EN 71-3 ELBA n° 09-344, data ose numri i botimit)



Tel: +355 4 22 69097
+355 4 22 69325
Fax:
E-Mail: info@dpa.gov.al

Politika për fushën e Akreditimit.

Kodi: DA-PO-015

Rishikimi nr 2
Dt: 26.04.2021

Faqe 3 nga 6

Modifikimet dhe përditësimet e metodave të testimit si edhe aktivitetet e ndërmarra që përfshijnë paraqitjen e rezultateve të përfuara ose të të dhënave të tjera të rëndësishme (p.sh rezultatet e vlerësimeve) duhet të kontrollohen dhe mirëmbahen të rregjistruara. Këto të dhëna do ti ofrohen Trupës Akredituese sipas kërkesës të saj.

Aplikanti duhet të saktësojë nëse akreditimi është kërkuar për metodat e testimit që ai kryen në lokalitë të tij apo tek klienti në teren. Kjo gjë shënohet në fushën e akreditimit.

Lokali: Kur DPA akrediton kapacitetin e një laboratorit për të kryer teste jashtë Lokaleve të tij kjo do të paraqitet në fushën , në një kollonë të veçantë si psh “ Kodi i lokalit” të Laboratorit ose në teren ose tjetër si “ Kategoria” 0 për rastin brenda laboratorit, 1- për rastin në teren ose 2- për të dy njëherësh.

5.1 Fusha e Testimit dhe Kalibrimit.

Formulimi i fushës të testimit dhe kalibrimit bazohet në ILAC-G18.

5.1.1 Shprehja e fushës të akreditimit të laboratoreve testues.

. Minimalisht rekomandohet që fushat të përmbajnë elementët që vijojnë :

(a) Referencën ndaj fushës të përgjithëshme të testimit që përfshihet në fushën e akreditimit (p.sh Testimi në Kimi, Testimi në Biologji, Testimi në Mjeksi, Testimi në Mekanikë etj)

(b) Identifikimi i grupit të produkteve, materialeve ose objekteve të testuara.

(c) Identifikimi i testeve specifike ose i llojeve të testeve që kryhen.

(d) Identifikimi i aspekteve të veçanta, standarteve (metodave) ose teknikave të përdorura.

DPA mund të kërkojnë informacione shtesë mbi fushën e praktikuar të akreditimit (p.sh shtrirjen e testimit ose matjeve, kufijt e analizës, llojet e aparaturave etj)

Shprehja e fushës për laboratorët mjekësorë bëhet sipas EA 4/17.

5.1.2 Shprehja e fushës të Akreditimit për laboratorët kalibrues është sipas ILAC G 18.

5.2 Përshkrimet e rekomanduara.

Përshkrimet e rekomanduara janë (për fushën e testimit)

 <p>Tel: +355 4 22 69097 +355 4 22 69325 Fax: E-Mail: info@dpa.gov.al</p>	Politika për fushën e Akreditimit.	Kodi: DA-PO-015
		Rishikimi nr 2 Dt: 26.04.2021
		Faqe 4 nga 6

5.2.1 Fushat e Testimit

Përshkrimet e rekomanduara për fushat e testimit janë :

1) Sipas Disiplinës Teknike.

- Testimi ne Akustikë.
- Testimi në Biologji.
- Testimi në Kimi.
- Testimi në Elektrike.
- Testimi në Rrezatimin Jonizues.
- Testimi në Mekanikë.
- Testimi në provat pa-shkatërim.
- Testimi në Optikë, Fotometri dhe Radiometri.
- Testimi në Termoteknikë.
- Testimi në Vibrim dhe Goditje.

2) Fushat e Testimeve shumë-disiplinore.

- Testimet Ambjentale.
- Testimet në Ekspertizë.
- Testimet në Shëndetësi dhe Higjenë.
- Teknologjia e Informimit.
- Testimet në Mjekësi.
- Testimi i Profesionalizmit.
- Testimi në Veterinari.
- Kombinime të cfarëdoshme.
- Testimi në Tekstil.
- Testimi në Inxhinjerinë Civile.

Përveç këtyre, DPA mund të bëjë nën-klasifikime të fushave të tyre të testimit për produkte, materiale ose shërbime..

5.2.2 Fushat e Kalibrimit (ose Matjeve)

- Kalibrimi në Akselerometri (dhe/ose Matja)
- Kalibrimet në Akustikë (dhe/ose Matja)
- Kimi (Gazi, Përzjerjet e gazrave, Std referues të pH , Kalibrimi i sipërfaqeve të teksturave.)
- Kalibrimet Dimensionale (dhe/ose Matja)
- Kalibrimet në Elektrike (dhe/ose Matja) DC & LF
- Kalibrimet në Elektrike (dhe/ose Matja) Radio-Frekuencat.
- Kalibrimet e Forcës (dhe /ose Matja)
- Kalibrimet e Rrjedhjeve (dhe/ose Matja)
- Kalibrimet e Fortësisë (dhe/ose Matja)

 <p>Tel: +355 4 22 69097 +355 4 22 69325 Fax: E-Mail: info@dpa.gov.al</p>	Politika për fushën e Akreditimit.	Kodi: DA-PO-015
		Rishikimi nr 2 Dt: 26.04.2021
		Faqe 5 nga 6

- Kalibrimet në Hygrometri (dhe/ose Matja)
- Kalibrimi në Fluksin Manjetik (dhe/ose Matja)
- Kalibrimet e Masës (dhe/ose matja)
- Kalibrimi NAËI ose verifikimi NAËI
- Kalibrimet në Optikë dhe Fotometri (dhe/ose Matja)
- Kalibrimi i Presionit dhe Vakumit (dhe/ose Matja)
- Kalibrimi në Radiologji (përfshi radiacionin jonizues) (dhe/ose Matja)
- Kalibrimet në Termoteknikë (dhe/ose Matja)
- Kalibrimet e Kohës dhe Frekuencave (dhe/ose Matja)
- Kalibrimet e Vibracioneve (dhe/ose Matja)
- Kalibrimi i Viskozitetit (dhe/ose Matja)
- Kalibrimi i Volumit (dhe/ose Matja)

Fushat e sipërshënuara janë nxjerrë nga kombinimet e fushave ekzistuese të kalibrimit të përdorura nga trupa të ndryshëm akreditues.

5.3 Formulimi i fushës së akreditimit për organet certifikuese të sistemeve të menaxhimit

Fushat e akreditimit për trupat certifikues të sistemeve të menaxhimit bëhet sipas kodeve të IAF dhe korrespondencës së tyre me kodet NACE. Fusha e akreditimit për organet certifikuese të sistemeve të menaxhimit të cilësive, mjedisit dhe jetes dhe sigurise në punë do të formulohet sipas IAF ID 1.

Për organet certifikuese të sistemeve të menaxhimit të pajisjeve mjekesore formulimi i fushës së akreditimit do të bazohet në dokumentin IAF MD 8.

Për organet certifikuese të sistemeve të menaxhimit të sigurise ushqimore, formulimi i fushës së akreditimit do të jetë sipas kategorive dhe nenkategorive të dhëna në standardin ISO/TS 22003.

Për organet certifikuese të sistemeve të menaxhimit të energjisë, formulimi i fushës së akreditimit do të jetë sipas kategorive të përcaktuara në standardin ISO 50003.


Për organet certifikuese të sistemeve të menaxhimit të vazhdimësisë së biznesit, formulimi i fushës së akreditimit do të bëhet sipas grupeve të dhëna në dokumentin DA-IN-006.

Për organet certifikuese që do të akreditohen për skemat e certifikimit sipas ISO 27001, ISO 20000-1, ISO 37001, ISO 39001, formulimi i fushës së akreditimit do të bëjë reference vetëm tek standardi përkatës.

Për organet certifikuese që do të akreditohen për skemat e certifikimit sipas ISO 27001, formulimi i fushës së akreditimit përveç standardit përkatës do të përfshijë edhe frazën “për të gjitha kodet e IAF”.

5.4 Fusha për organet inspektuese

Fusha e akreditimit për organet inspektuese formulohet në përputhje me ILAC G 28

 <p>Tel: +355 4 22 69097 +355 4 22 69325 Fax: E-Mail: info@dpa.gov.al</p>	<p>Politika për fushën e Akreditimit.</p>	<p>Kodi: DA-PO-015</p>
		<p>Rishikimi nr 2 Dt: 26.04.2021</p>
		<p>Faqe 6 nga 6</p>

5.5 Fusha për organet e certifikimit të personave

Fusha e akreditimit për organet certifikuese të personave përfshin informacionin për personat apo grup personat që certifikohen, skema e certifikimit dhe titulli i skemës së certifikimit..

Drejtori i Përgjithshëm

Data: 26.04.2021

Armond HALEBI